DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-411/8
Date Datum Date 16.03.2017

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL | |
| Përmes: | Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së, | |
| Nga: | Besim Murtezani, U.D. Udhëheqëse i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 14/03/2017<br>Nr. 020-411 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01Nr.104/1-5516/17, për Aprovimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2016. |
| I miratuar më datë më datë: 28.02.2017 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2017 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi*** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-411/8
-VI-
Data Datum Date 16.03.2017

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Besim Ilazi, gradonačelnik opštine Kačanik<br>Xhelal Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik | |
| Kopija: | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini<br>Pravno odeljenje i monitorisanje opština, MALS | |
| Preko: ZA: BADZAM GECAJ | Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u | |
| Od: | Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljejna i monitorisanje opština, MALS | Datum:<br>14/03/2017<br>Br.020-411 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik | |
| Vrsta akta: | Odluka | |

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka 01 br. 104/1-5516/17 za usvajanje izveštaja rada izvršnih organa opštine za 2016. godinu. |
| Usvojena dana: 28.02.2017. |
| Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 07.03.2017. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01Nr. 104/01-5516/17**
**Kaçanik, 28.02.2017**

Në bazë të nenit 40.2 (d) e Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28, 4 qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 56 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 Shkurt 2017, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2016**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti **01Nr. 104/01-5516/17** në tekstin e mëtejmë " Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2016" i hartuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës.

2. Raporti si në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban pikësynimet në lidhje më realizimin e detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Ekzekutivit të komunës (kryetarit të komunës dhe të drejtorive komunale) si dhe nivelin e realizimit të tyre për aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2016.

3. Raporti i ekzekutivit të komunës është i përmbledhur në gjithsej 26 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Me këtë Vendim njoftohen:**
1.Kryetari i Komunës,
2. Drejtoritë Komunale, dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Bashi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

22.02.17 KAÇANIK
01 104/01-5576 /.

# RAPORTI I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2016

Kaçanik,Shkurt 2017

## Vështrim hyrës

Në Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2016 kam nderin dhe privilegjin që të prezantoj angazhimet, sfidat dhe të arriturat e vitit 2016.
Viti 2016 ka qenë i vit i sfidave, angazhimeve, e gjithsesi edhe i sukseseve.
Të gjitha aktivitetet e Komunës së Kaçanikut janë realizuar në harmoni të plotë me Statutin Komunës dhe zbatimin e përgjegjësive si kryetar i Komunës duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj, jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme, rininë etj.
Një bashkëpunim të sinqertë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet dhe debatet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, ndërsa janë trajtuar tema të ndryshme me theks të veçantë Buxheti i Komunës për vitin 2017, ndërkohë që janë mbajtur dy dëgjime buxhetore dhe dy debate te rregullta me qytetarë .
Në këtë vështrim më lejoni që të përmend disa prej dhjetëra të arriturave kryesore që janë shënuar gjatë këtij viti, si rezultat i përkushtimit të Komunës së Kaçanikut dhe institucioneve tjera qeveritare dhe jo qeveritare me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë tërë vitit.
Viti 2016 ishte viti më i suksesshëm që nga paslufta sa i përket mbledhjes së të hyrave vetanake komunale. Gjatë këtij viti në arkën komunale janë arkëtuar mbi 630 mijë apo 90 % realizimi, planifikimit të inkasimit nga të gjitha llojet e të hyrave komunale në shumë prej 709 mijë 672 euro.
Progres të veçantë kemi arritur tek të hyrat e tatimit në pronë, ku është regjistruar tejkalim i planifikimeve vjetore, nga plan i inkasimit në shumë prej 265 mijë euro sa ishte planifikuar, janë inkasuar 280 mijë euro apo 105 %.
Poashtu edhe ekzekutimi i buxhetit është realizuar me sukses, ku nga 5,605,226 euro nga grantet qeveritare janë shpenzuar 5,603,567 euro, apo 99.97 % e mjeteve nga grantet qeveritare.

Përmes pagesës së tatimit në pronë qytetarët kanë investuar në infrastrukturë dhe mirëqenien e tyre dhe njëkohësisht kanë shprehur besimin ndaj institucioneve komunale.
Gjatë këtij viti janë realizuar 19 projekte kapitale në asfaltimin e rrugëve, ku do të veçonim asfaltimin e segmentit të rrugës Gajre-Ivajë-Shtrazë me gjatësi 1600 metra si dhe asfaltimin e rrugës Dushkajë- Stagovë, 22 projekte në rehabilitimin e rrugëve lokale me shtresë zhavori, 11 projekte në rregullimin e kanalizimeve fekale dhe atmosferike, janë shtruar 1699 metra trotuar, tre projekte në rregullimin e ujësjellësit si dhe janë realizuar18 projekte të ndryshme si në mbrojtje të mjedisit, rregullimi i parqeve etj.
Edhe në shëndetësi kemi punuar vazhdimisht në krijimin e kushteve sa më të mira, në vitin 2016 kemi përuruar objektin e ri të QKMF-së, objekt i ndërtuar sipas standardeve të larta, ndërsa kemi krijuar kushte dhe infrastrukturë të mirëfilltë edhe nëpër ambulantat familjare nëpër fshatra.
Ndërkohë sa i përket mirëqenies sociale vazhdimisht jemi munduar që të krijojmë lidhje dhe bashkëpunime me organizata humanitare, për mirëqenien e familjeve skamnore.

Në arsim gradualisht po kompletohet në tërësi infrastruktura dhe tashmë jemi fokusuar krejtësisht në ngritjen e kualitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Jemi në fazën implementuese të rregullimit të aneksit të shkollës në Fshatin Stagovë, ndërsa këtë vit jemi të bindur se do të ndërtohen shkolla të reja dhe infrastruktura shkollore do të jetë në mesin e prioriteteve. Edhe këtë vit ka vazhduar ndarja e bursave për studentët e dalluar, duke u lehtësuar kështu barrën financiare të studimeve. Ndërsa në sektorin e kulturës Rinisë dhe Sportit edhe këtë vit nuk kanë munguar projektet dhe aktivitetet e ndryshme. Renovimi i Shtëpisë së Kulturës " Xheladin Kurtaj", ka mundësuar krijimin e kushteve sa më të mira për realizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore, ndërsa nuk ka munguar edhe përkrahja financiare për projektet e të rinjëve në të mirë të shoqërisë. Poashtu vlen të përmenden shumë aktivitete kulturore e sportive, të cilat janë realizuar në kuadër të ditëve të mërgatës në Kaçanik. Investimet nuk kanë munguar edhe në fushën e trashëgimisë kulturore. Këtë vit është përuruar restaurimi i Kalasë së Qytetit, si njëri ndër monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Komunën e Kaçanikut.
Në Vitin 2016 është themeluar komisioni komunal për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim,si një hap për zhvillimin ekonomik. Përmes këtij komisioni prona e pashfrytëzuar komunale do të shfrytëzohet nga qytetarët të cilët dëshirojnë të zhvillojnë biznese të ndryshme që njëkohësisht do të ndikonte në krijimin e vendeve të lira të punës.
Duke e parë bujqësinë si një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, ka vazhduar mbështetja dhe ndarja e granteve në bujqësi, ndërsa edhe këtë vit fermat në biznese të zhvillimit të bujqësisë janë përkrahur shumë nga Komuna e Kaçanikut, si në projektet e kultivimit të mjedrës, kultivim të fidanëve etj.
Edhe gjatë vitit 2016 jemi munduar në krijimin e lehtësirave administrative për qytetarët, janë evituar pritjet e gjata nëpër sportele edhe gjatë kohës së verës, kur kishte fluks të mërgimtarëve.
Edhe gjatë vitit 2016 kemi punuar nën frymën e bashkëpunimit me institucionet qendrore, ku vlen të përmendet bashkëpunimi i shkëlqyer me Ministrinë e Infrastrukturës si dhe me shumë ministri të tjera, si dhe bashkëpunimi me organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që kanë synim krijimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e Kaçanikut.
Nëse në retrospektivë do të përpiqeshim të përshkruanim këtë vit, mund të themi se ky ishte një vit i sukseseve, vit i arritjeve dhe vit i angazhimeve për Komunën e Kaçanikut.
Para vetes na pret një rrugë plot sfida, punë e përkushtim edhe për vitin 2017, por të gjithë e dimë se falë bashkëpunimit të gjithanshëm, jemi të bindur se viti 2017 do të jetë vit i mirëqenies së qytetarëve dhe vit i sukseseve të reja për Komunën e Kaçanikut.

Prioritetet kryesore për Kaçanikun vazhdojnë të jenë:

- Ushtrimi i përgjegjësive dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e punës
- Mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës dhe zbatimi i planeve investuese të komunës, përkatësisht investimet substanciale në infrastrukturë fizike duke përfshirë rrugët, ujin e pijshëm dhe kanalizimet.
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies së qytetarëve.

- Krijimi i kushteve të volitshme për investime të drejtpërdrejta, shtimi i vendeve të të reja të punës dhe zhvillimit ekonomik.
Rregullimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe ngritja e cilësisë në arsim
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje
- Hartimi i hartave zonale
- Ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës, administratën e saj dhe zbatimin e akteve të Kuvendit të Komunës.
- Bashkëpunim ndërkomunal, nivelet qendrore, Asociacionin e Komunave të Kosovës Organizatat ndërkombëtare etj.

Shërbimet janë ofruar përmes drejtorive dhe zyrave si në vijim:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

Çfarë kemi arritur

Tabela në vijim përmbledhë aktivitetet dhe arritjet kryesore gjatë vitit 2015. Më shumë hollësi janë dhënë në Shtojcën e bashkëngjitur në këtë raport, në të cilën jepen informata lidhur me performancën e secilës drejtori/program.

Prioriteti 1: Ofrimi i shërbimeve të shpejta e cilësore

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA KAÇANIK - OPŠTINA KAÇANIK - MUNICIPALITY OF KAÇANIK

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

| Nr | Departamenti | Në pritje për pranim | Të pashqyrtuara | Në proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur poshtë | Pezulluar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 01-Shërbimi i Kryetarit | 0 | 7 | 5[illegible] | 1322 | 261 | 1 | 1 | 1647 |
| 2 | 02-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | 0 | 15 | [illegible] | 26413 | 16 | 38 | 7 | 26491 |
| 3 | 03-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 0 | 2 | [illegible] | 254 | 6 | 0 | 2 | 255 |
| 4 | 04-Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës | 0 | 36 | [illegible] | 408 | 455 | 0 | 1 | 901 |
| 5 | 05-Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit | 0 | 4 | [illegible] | 5408 | 5 | 4 | 0 | 5424 |
| 6 | 06-Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit | 0 | 67 | 23[illegible] | 5773 | 55 | 6 | 34 | 6156 |
| 7 | 07-Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike | 0 | 0 | 1[illegible] | 300 | 53 | 0 | 0 | 369 |
| 8 | 08-Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë | 0 | 0 | [illegible] | 526 | 105 | 0 | 3 | 634 |
| | Gjithsej: | 0 | 131 | 309 | 40404 | 956 | 49 | 48 | 41897 |

| Prioriteti 2: Procesi i trajtimeve të ndërtimeve pa leje | |
|---|---|
| **Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti** | **Arritjet/progresi/performanca kyçe gjatë vitit 2016** |
| Regjistrimi i objekteve të pa Leje pa leje dhe futja në Regjistrin shtetëror të ndërtimeve pa Leje i cili është publikuar në faqet e MMPH. Fushata e zhvilluar në bashkëpunim me MMPH, për sensibilizimin e këtij procesi në teren dhe fillimi i procesit të aplikimit për marrjen e lejes së legalizimit i cili zgjat deri më 16.03.2016. | Janë identifikuar afër 8679 objekte pa leje dhe janë futur në sistem të dhënat.<br>Kemi 13 raste të aplikimit dhe janë lëshuar 4 Leje për legalizim.<br>Në vitin 2016 janë lëshuar 10 Leje Ndërtimi.<br>Kanë filluar me vendosjen e numrave nëpër shtëpi |

Prioriteti 3: Ofrimi i shërbime publike dhe krijimi i infrastrukturës me theks të veçantë në rrugë, rrjete ujësjellësish dhe kanalizime

| Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti | Arritjet/progresi/ Performanca kyçe gjatë vitit 2016 |
|---|---|
| Përmirësimi i infrastrukturës rrugore | ➢ Janë asfaltuar rreth 8.441 km rrugë.<br>➢ 4.421 km kanalizime fekale .<br>➢ 439 m' kanalizime atmosferike .<br>➢ Janë shtruar rreth 306 m' apo 968.50$m^2$ rrugica me kubëza betoni.<br>➢ Është ndërtuar trotuar për këmbësor në gjatësi 1699.50<br>➢ Është vazhduar me projektin "Sanimi, rekonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore për 9 fshatra të komunës. ku është punuar rrjeti primar nga burimet deri në peshoren kryesore dhe është ndërtuar rezervuar në fshatin Sllatinë 50$m^3$, si dhe është në ndërtim edhe rezervuari 740$m^3$ në lagjen Prushaj-Soponicë.<br>➢ Është përfunduar rrjeti sekondar i ujësjellësit në Gilloboqicë në gjatësi rreth 11km. |
| Mirëmbajtja e ndriçimit publik | ➢ Rrugët e qytetit në vazhdimësi kanë qenë të ndriçuara nga ndriçimi publik<br>➢ Është bërë zgjerimi i rrjetit në disa lagje të qytetit në gjatësi 300m dhe janë vendosur 6 trupa të ri ndriçues. |
| Mirëmbajtja e rrugëve lokale | ➢ Gjatë vitit DESHP-ja është angazhuar në mirëmbajtjen sistematike të rrugëve ekzistuese të cilat janë të asfaltuara dhe rrugëve të shtruara me shtresë zhavori.<br>➢ Janë rehabilituar rrugë lokale me shtresë zhavori me sasi rreth 2654$m^3$ zhavor |

| Prioriteti 4: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore | |
|---|---|
| Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti | Arritjet/progresi/performanca kyçe gjatë vitit 2016 |
| Asfaltimi i rrugëve lokale | ➢ Është arritur të asfaltohen rrugë në gjatësi 8.441km dhe të shtrohen me kubëza betoni rreth 306 m apo 968.50$m^2$ rrugica ,<br>➢ Rehabilitimi 521$m^2$ pjesëve të dëmtuara |

| | |
|---|---|
| | të asfaltit në qytet dhe zona rurale.<br>➢ Ndërtimi i trotuarit për këmbësor në fshatin Begracë-faza e II-të dhe ndërtimi i stazës për këmbësorë nga fshati Duraj-Elezaj. |

**Prioriteti 5: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes përmbushjes së nevojave për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore**

## DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës janar – Dhjetor 2016 ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të ngritet cilësia dhe efikasiteti në shërbimet primare shëndetësore , shërbimet sociale dhe shërbimet e inspektimit sanitar .

Gjatë vitit 2016 në kuadër të DSHMS-së janë ndihmuar 91 familje:

- 29 familje janë ndihmuar me mjete financiare në shumë prej
- 62 familje janë ndihmuar me nga një pako ushqimore ,ku vlera e pakove ushqimore ishte prej 50 deri 70 €.
- Me iniciativën tonë , në bashkëpunim me disa operatorë ekonomik që zhvillojnë veprimtarin në komunën tone siç janë **KIVO dhe EL-PLAST**, për festat e fund vitit janë ndihmuar me pako ushqimore 55 familje me gjendje te rënd ekonomike .

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur bashkëpunim të ngushtë KFOR-in Polak , Caritas-Luxemburg ,zyren **japoneze** ,organizata qeveritare turke **TIKA** ,shoqatën humanitare Kaçanikase , me Organizatën Humanitare **Human Appeal Int, Bektelenka,** ku nga Bektelenka janë ndihmuar 52 familje me pako ushqimore ku vlera e pakos ka qenë 50€. Organizata Humanitare **Human Appeal Int.** ka ndihmuar 50 familje me pako ushqimore ku vlera për person ka qenë 45€. 115 persona me veshmbathje vlera për person ka qenë 20€, ndërsa e njëjta organizatë ka ndihmuar 105 familje me mish .

Në bashkëpunim me ekipin e Zyrës Ndërlidhëse Monitoruese të KFOR-it Polak, në kuadër të aktiviteteve bamirësisë, ka dhuruar pako higjienike dhe pajisje shkollore familjet skamnore, kurse donacion me para të gatshme janë ndihmuar 22 familje shuma e mjeteve ka qenë prej 100-300 duke u bazuar në anëtar të familjeve dhe nga një donator janë ndihmuar 22 familje me pako ushqimore. Kurse Shoqata humanitare Kaçanikase ka ndihmuar me karroca invalidore ,pajisje higjenike etj.
Falë bashkëpunimit me Organizatën TIKA ne muajin mars kjo organizata ka dhuruar një donacionin ultraza me tre sonda me vlerë prej 22.000€.
Bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me Zyrën Japoneze dhe në muajin mars do të dhuroj një auto-ambulancë dhe një veturë për bartjen e personave me dializë me vlerë prej 70.000€.
Gjithashtu Komunat e Moosseedorf-it komunë partnere me Komunën e Kaçanikut ka sjellur donacion dy sterilizator për nevoja të QKMF-së.

### SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2016 është bërë riorganizimi i brendshëm i QKMF-se , ku është ngrit cilësia e shërbimeve shëndetësore primare dhe implementimi i mjekësisë familjare në QKMF-e,QMF-e dhe AMF-të ekzistuese.

Është bërë mbulim më i mirë me staf mjekësor ne QMF dhe AMF

QMF.

QMF-Doganaj pesë ditë në javë.

AMF-Bob pesë ditë në javë.

QMF-Kaçanik i vjetër pesë ditë në javë.

QMF-Glloboqicë katër ditë në javë.

AMF-Stagovë tri ditë në javë

AMF-Biqec tri ditë në javë.

AMF-Dubravë tri ditë në javë.

AMF-Elezaj dy ditë në javë.

AMF-Shtrazë. Kotlinë. Ivajë një ditë në javë dhe

AMF-Begracë dy ditë në javë.

Ka përfunduar ndërtimi i QKMF-s së re sipas standardeve.

Kurse ka filluar me shërbime në muajin maj të vitit 2016

Është rregulluar dhoma e arkivit(pajisja me rafta të nevojshme) dhe është sistemuar arkivi i cili ka qenë i ndarë nëpër hapësira të ndryshme të AMF-ve dhe QMF-ve

Është pajisur dhe funksionalizuar hapësira e lavanterisë në hapësirat e reja të QKMF-s

Është pajisur në tërësi me rolet në të gjitha hapësirat e QKMF-së.

Është pajisur edhe shërbimi i higjiensteve me pajisje të nevojshme për mbajtjen e higjienës

Është ndërtuar dhe funksionalizuar shërbimi i kartotekës i cili shërbim ka munguar në projektin e QKMF-s së re

Ka filluar aplikimi i sistemit te kartelave shëndetësore dhe në të njejten kohë të gjithë pacienten qe marrin kartela shëndetësore janë pajisur me një kartel të veçantë ku janë të dhënat e nevojshme dhe numrat e kartonit shëndetësor.

Kemi pajisur të gjitha hapësirat e QKMF-s me inventar tërësisht të re(inventari i vjetër është larguar nga hapësirat e QKMF-S)

Kemi bërë pajisjen e sektorëve te caktuar me kompjuter të ri

Është funksionalizuar një kuzhinë brenda hapësirave të QKMF-s për nevojat e stafit punues

Ka përfunduar rregullimi i rrethojave te QKMF-s dhe anekseve për lëndë djegëse

Gjatë këtij viti kemi arritur të bëjmë shenjëzimin e hapësirave të QKMF-s me shenjat e nevojshme orientuese për pacientet në objekt dhe jashtë objektit

Është aktivizuar sistemi i kamerave në QKMF

Është bërë renovimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në AMF-Stagove

Janë bërë renovime te brendshme në disa QMF dhe AMF

Është funksionalizuar shërbimi shëndetësor 24/7 në QKMF

Kemi filluar punën për herë të parë pas luftës me tri ndërrime

Kemi filluar punët me spitalin rajonal të Ferizajt për dializën dhe referimet nga QKMF-ja në spital

Kemi bërë një marrëveshje bashkëpunimi me spitalin rajonal të Ferizajt për menaxhimin-eliminimin e mbetjeve medicionale në impiantin-sterilizatorin e këtij spitali

Raportohet rregullisht në IKSHP-se qendrore në Prishtinë për ecurinë e vaksinimit

Këtë vit furnizimi me barna ka qenë me i dobët se vitin e kaluar

Gjatë vitit furnizimi me barna nga lista esenciale është përmirësuar dukshëm krahasuar me vitin paraprak .

Vlen të përmendet se ka filluar ofrimi i shërbimeve shëndetësore primare për herë të parë me tri ndërrime me çka është ngrit cilësia e shërbimeve dhe është ulë ngarkesa e punës për stafin shëndetësor.

Është bërë rinovimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në AMF-e Stagovë ,është bërë rrethoja e oborrit dhe aneksi për lëndë djegëse (dru) QMF-e Bob ,është ndërtuar aneksi për lëndë djegëse dru në QMF-e Doganaj

- Gjatë vitit kemi pasur vizita monitoruese nga ministria e shëndetësisë , ku nga dy vizitat monitoruese
    - Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë
    - Inspektorati sanitar dhe raportet e tyre janë shumë pozitive
- Kemi bere raportimin e rregullt të sëmundjeve ngjitëse në IKSHP-e rajonal- Ferizaj
- Si dhe raportet e rregullta ne IKSHP-se qendrore në Prishtinë për ecurinë e vaksinimit .

Numri i pacientëve për këtë vit ishte i ngjashëm me vitet e kaluara

## SHËRBIMI SOCIAL

Gjatë vitit 2016 në kuadër të detyrave të parapara .në lëmin e ndihmave social nëpunësit e shërbimeve sociale në kuadër të Qendrës për Punën Sociale kanë kryer dhe realizuar në harmoni me Ligjin e Skemës sociale Nr. 2003/15 dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/096 këto punë dhe detyra :

- Nëpunësit e ndihmave sociale gjatë vitit 2016 kanë dërguar në komision mjekësor 598 kërkesa ku prej tyre 596 pozitiv 2 janë refuzuar .

Në kuadër të QPS kanë funksionuar dy ekipet :

- Ekipi i shërbimeve sociale dhe ekipi i asistencës sociale

Ekipi i shërbimeve sociale gjatë periudhës një vjeçare ka trajtuar :

- Fëmijët pa dy prindër . gjatë këtij viti me pagesë janë **7** . kurse **8** prej tyre e gëzojnë të drejtën në SNS familjet e dëshmorëve ose viktimat civile të luftës . këta fëmijë janë në përkujdesje të përhershme të QPS-së.
- Brenda kësaj periudhe një vjeçare janë paraqitur **2 kërkesa** për birësim (adoptim )të fëmijëve .
- Ekipi i shërbimeve sociale gjatë këtij viti ka trajtuar edhe 3 çifte bashkëshortore me 4 fëmijë , ku nëpunësit e QPS-së , kanë bërë sanimin e mardhenjeve bashkëshortore të këtyre rasteve .Këto raste nënëpunësi i shërbimeve socialekëto raste i viziton dhe i ka në tretman të vazhdueshëm.
- Delikuent të mitur ka pasur**59raste** , të cilët janë trajtuar për risocializim –dhënia e këshillave nga nëpunësit e shërbimeve sociale **kemi 42**.
- Me ligjin e ri për përkrahjen e familjeve të fëmijëve me nevoja të veçanta gjatë këtij viti të drejtën për ndihmë financiare e kanë **realizuar 62 cilat i marrin 100 €** për çdo muaj .prej tyre **5 janë të verbër që marrin nga 200€ për çdo muaj .**

Nga evidenca që është mbajtur rregullisht nga ekipi i asistencës sociale shfrytëzuesit e ndihmave sociale .mesatarja mujore ka qenë **800 familje** që shfrytëzojnë ndihmat sociale

Gjatë kësaj periudhe në Qendrën për punë sociale janë referuar dhe trajtuar **7 raste** të dhunës në familje(1 rastë më shumë se vitin e kaluar), ku pas sanimit të mardhënjeve familjare të njejtat janë kthyer në familjet e tyre. Në të gjitha rastet kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Gjykatën, SHPK, Zyren për mbrojtjen e viktimave, familjen, si dhe strehimoret- shtëpitë e sigurta.

Po ashtu gjatë këtij viti që po e lëmë pas janë shqyrtuar **10** ankesa ( ankesa në shkallën e parë) janë refuzuar të gjitha në shkallën e dytë .

Çdo muaj në Qendër nëpunësit e SAS-it janë intervistuar mbi **152** raste( prej tyre kanë aplikuar 131 , pre 94 të aprovuara, ndërsa 37 të refuzuara ) të tjerët nuk i kanë aplikuar sepse nuk i kanë plotësuar kriteret sipas ligjit të SAS-it **2003/15** .

.Nëpunësit e S.A.S-it gjatë vitit **2016** kanë lëshuar 7 vërtetim për studentët të cilët janë shfrytëzues të SAS-it.

## SHËRBIMI I INSPEKCIONIT SANITAR

Të gjitha kërkesat e palëve të adresuara pranë zyrës së inspektorit sanitar janë shqyrtuar dhe janë kryer sipas detyrës zyrtare :

- Në bashkëpunim me Inspektorin e tregut janë lëshuar 40 pëlqime mbi plotësimin e kushteve teknike ,higjeno –sanitare të objekteve për zhvillimin e veprimtarie tregtare .
- Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve janë lëshuar 7 pëlqime mbi harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro-teknike të ndërtimit .

- Bazuar në U/A(**shëndetësi ) Nr. 14/2013 Për Qarkulluesit me pakicë për produktet dhe pajisjet medicinale ,Ligji Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi** ,U/A **08/2014** ,në procedurën e licencimit janë lëshuar 6 Aktvendime mbi plotësimin e kushteve higjeno – teknike dhe sanitare të barnatoreve dhe ordinancave private shëndetësore .
- Për mos rrespektim të **Ligjit Nr. 04/L-156 Për kontrollin e duhanit** ,U/A **(shëndetësi ) Nr.09/2015 Mjediset pa tym duhani,**
  Janë shqiptuar gjoba mandatore **7 personave fizik** ,pranë Gjykatës themelore –divizioni për kundërvajtje ,inspektori sanitar ka parashtruar **8 kërkesa** për shqiptimin e masave ndëshkuese konform dispozitave Ligjore në fuqi .
- Për mos respektim të **Ligjit Nr.03/L-016 Për Ushqimin** , dhe shkeljeve të normave sanitare dhe mos respektim të vendimeve ,janë gjobitur me dënime mandatore 8 **operator ekonomik .**
- **Bazuar në Ligjin nr.02/L-109 –Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse** ,janë lëshuar **20 vendime** për kryerjen e kontrollit shëndetësor ndaj bacilbartjes për punëtorët që vijnë në kontakt të drejtpërdrejt me ushqimin ,furnizim të popullatës me ujë të pijshëm ,me barna farmaceutike , mjekimin e pacientëve etj.
- Artikujt ushqimor që nuk i kanë përbush kushtet për konsum dhe që i ka skaduar afati i përqendrueshmërisë janë asgjësuar **,ku vlera e artikujve është 200 €.**
- Është kryer **Dezinfektimi , Deratizimi , dhe Dezinsektimi** i të gjitha furrave të bukës dhe disa objekteve hoteliere .
- Janë inspektuar të gjitha objektet edukativo – arsimore ,
  **( kushtet higjeno –sanitare janë në nivel mesatar) .**

- Është bërë inspektimi i të gjitha objekteve hoteliere dhe me këtë rast është bërë edhe depistimi i këtyre objekteve dhe janë marrë disa strisho për ekzaminim mikrobiologjik – ku mund të theksohet se strishot e marra kanë rezultuar në nivelin e kënaqshëm .
- Në bashkëpunim me Inspektorët e nivelit Qendror në kuadër të Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinarisë kemi kryer inspektime të përbashkëta ,ku gjatë kontrollit inspektues janë hartuar 10 procesverbale .
- Gjatë vitit 2016 nga Instituti Rgjional-Ferizaj janë analizuar **56 mostra kimike dhe 53 mostra bakterologjike** të ujit të pijshëm. ku të gjitha mostrat kanë rezultuar sipas standardeve të OBSH-së.
- Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe kemi pas bashkëpunim të ngushtë me IKSHP-rajonal –Ferizaj ,AUV-së,Gjykatën Komunale dhe Policinë e Kosovës.

| Prioriteti 6: Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë | |
|---|---|
| **Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti** | **Arritjet/progresi/performanca kyçe gjatë vitit 2015** |
| ▫ Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i | - Nga 473 maturantë të cilët iu kanë nënshtruar provimit të maturës, në afatin e Qershorit, rezultat |

| | |
|---|---|
| njohurive të nxënësve<br>Provimi i maturës. Është mbajtur provimi i maturës në dy afatet; në atë të qershorit ( pjesa e parë dhe e dytë) dhe gushtit (pjesa e parë dhe e dytë ). Provimit iu kanë nënshtruar mbi 470 maturantë nga të 2 shkollat e mesme të Komunës sonë.<br><br>• Testi i Arritshmërisë. Testit të arritshmërisë sivjet iu kanë nënshtruar afër 720 nxënës të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë. Semimaturantët kaçanikas kanë arritur rezultate relativisht të mira duke arritur nivelin e kalueshmërsë në shkallë komune 56.38 % e që krahasuar me vitin paraprak (54.91 %) është shënuar ngritje për afër 2 %. | pozitiv kanë arritur 321 prej tyre ose 67,87 %. Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 283 nxënës maturant të cilët kanë hyrë në provimi e maturës, 251 prej tyre kanë treguar rezultat pozitiv apo 88.6 %, ndërsa vetëm 32, nuk kanë arritur pikët e nevojshme, ndërkohë që provimit të maturës iu kanë nënshtruar në afatin e dytë të gushtit. Në Shkollën e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" rezultatet e provimit të maturës edhe sivjet nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar. Nga gjithsej 190 nxënës, rezultat të kënaqshëm kanë treguar vetëm 70 prej tyre ose 36,84 % . ndërsa 120 të tjerë kanë pasur mundësin t'i nënshtrohen procesit të testimit në afatin e gushtit.<br>- Semimaturantët kaçanikas kanë arritur rezultate relativisht të mira në Testin e Arritshmërisë duke arritur 56,38 % nivelin e kalueshmërsë në shkallë komune e që krahasuar me vitin paraprak (54.91 %) është shënuar ngritje për afër 2 %. |
| Organizimi i trajnimeve profesionale | - Gjatë vitit 2016, kanë vazhduar trajnimet e mësimdhënësve, në bashkëpunim me MASHT-in dhe GIZ-in, në fusha të ndryshme. |
